



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
STINA KLINA

Nr.No. bi.

360-367/11/23

Data-Data

25.10.2023

Klinë Klina



QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË

KOMUNËS SË KLINËS

DHE

QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS

STREHIMORE PËR VIKTIMA TË DHUNËS



Ne përputhje me Nenin 17.1(k) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28), dhe në përputhje me Statutin e Komunës së Klinës , u pajtuam për këtë

Memorandum të Mirëkuptimit (MM) për mbështetje financiare të (QMG) Qendrës për Mirëqenien e Gruas (strehimores për viktimat të dhunës në familje)

Neni 1

Qëllimi i memorandumit

1. Qëllimi i këtij memorandumit është për të përkrahur QMG me mjete financiare për të ofruar shërbime të strehimit, rehabilitimit, dhe reintegrimit për gra dhe fëmijë viktimat të dhunës në familje të Komunës së Klinës.
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të sigurojë mbështetje financiare nga Komuna Klinë për nevojat e QMG Strehimores për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje për vitin 2023
 - 2.1 .Objekti i QMG Strehimores gjendet në Komune e Pejës
 - 2.2. Strehimorja është e licencuar për shërbimin e viktimave të dhunës për K. Klinë

Neni 2

Fushëveprimi

1. Komuna do të mbulojë shpenzimet e QMG strehimores bazuar në planin vjetor të strehimores
2. QMG do të strehohet gratë dhe fëmijët , viktimat të dhunës në familje nga 1 gjer 6 muaj dhe do të marrin të gjitha shërbimet e ofruara në këshillim, rehabilitim dhe reintegrim., duke përfshirë ushqim, veshmbathje, medikamente, kurse dhe trajnime)

Neni 3

Obligimet e përfituesit

1. QMG obligohet të dorëzojë kërkesën bashkë me planin vjetor për mbështetje financiare tek zyra e Kryetarit të Komunës
2. QMG obligohet të dorëzojë raportin e shpenzimeve vjetore në drejtorinë për buxhet dhe financa.



Neni 4

Obligimet financiare të komunës

1. Komuna e Klinës obligohet ti ndajë mjete financiare për shërbimet e ofruara ndaj grave dhe fëmijëve të Komunës së Klinës për nevojat e QMG strehimores sipas paragrafit 2 të nenit 1. të këtij memorandumi me shumën prej 3000 euro.

Neni 4

Zgjedhja e mosmarrëveshjes

1. Mosmarrëveshjet në zbatimin e këtij memorandumi zgjidhen me mirëkuptim përmes palëve nënshkruese

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Kryetari i Komunës duhet të sigurojë zbatimin e plotë të këtij memorandumi të mirëkuptimit
2. Memorandumi i mirëkuptimit nënshkruhet në dy kopje origjinale secila palë merr nga një kopje
3. Memorandumi do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit

Kryetari i KK Klinë
Prof. Dr. Zenan Elezari



Data: 18.10.2023

QMG Pejë
MA. Ardita Ramizi Bala



Data: 15.10.23